



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:009918  
Datë: 05.03.2024  
Numri i dokumentit: 05412784

**C-IV-14-6603**

*Ankuesi*

**N M. E- Fsh. G**, Podujevë

*kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit për N.SH.”Gërmia” (në likuidim)**, Rruga “Dritan Hoxha”,  
Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 5 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së ankuesit N M. E- Fsh. G, Podujevë.**
- Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin, apo kujdestari i tij kërkon vazhdimin e procedurës, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 27 tetor 2014, ankuesi parashtrij ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për paga të pa paguara të asistencës sociale nga marrëdhënia e punës në shumë prej 1.500,75 Euro, për periudhën kohore Janar 2005 deri më Gusht 2007 nga NSH “Gërmia” (në likuidim).

Me 8 shkurt 2024, gjykata lëshoj për ankuesin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin, se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr, mirëpo në flet dërgesë nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se pala ankuese “ka vdekur”.

### **Arsyetimi ligjor**

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit.

Neni 76.4 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

*Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së:

*Procesi gjyqësor ndërpritet:*

*a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;*

Ne vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh:

*Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.*

Me 8 shkurt 2024, Gjykata ka tentuar që ankuesit t’ia dërgojë vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar, por nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se pala “ka vdekur”.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha, Gjyqtare \_\_\_\_\_